



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA DURRËS**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDIM**

Nr. 23, datë 12.06.2026



**PËR MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDIT PREJ 4010444 (KATËR MILIONË E DHJETË MIJË E KATËRQIND E DYZET E KATËR) LEKË TË PARAFINANCUARA NGA PROJEKTI SUSTAINABLE MOBILITY UPGRADE - SUMO 2.0, PROGRAMI INTERREG IPA SOUTH ADRIATIC (2021-2027)**

Në mbështetje të Ligjit nr. 65/2022 “Për ratifikimin e marrëveshjes financiare kuadër të partneritetit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe Komisionit Evropian për rregullat specifike të zbatimit të asistencës financiare të BE-së për Republikën e Shqipërisë në kuadër të Instrumentit për Asistencën e Paraanëtarësimit (IPA III)”, Ligjit nr. 8/2024, “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, Republikës së Italisë dhe Komisionit Evropian, i cili përfaqëson Bashkimin Evropian, për programin e bashkëpunimit (Interreg VI-A) IPA Itali–Shqipëri–Mali i Zi (Adriatiku Jugor) 2021-2027”, Ligjit Nr.139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit Nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjit Nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Udhëzimit nr.10, datë 12.07.2024 “Për kontrollin, regjistrimin, përdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e marrëveshjeve ndërkombëtare”, Marrëveshjes së Partneritetit të nënshkruar ndërmjet Partnerit udhëheqës së Projektit Luka Bar AD dhe institucionit të Bashkisë Durrës, nënshkruar më datë 01.09.2025, për projektin “Sustainable Mobility Upgrade 2.0 - SUMO 2.0”, programi i BE-së Interreg IPA SOUTH ADRIATIC (2021-2027), me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

**KËSHILLI BASHKIAK**  
**V E N D O S I :**

1. Miratimin e përdorimit të fondit prej 4,010,444 (katër milionë e dhjetë mijë e katërqind e dyzet e katër) lekë (në vlerën 20% të shumës totale të financimit të projektit nga fondet e Programit Interreg), të ardhur si parafinancim nga projekti SUMO 2.0., me kod të produktit të projektit G107010 të ardhur nga Dega e Thesarit Durrës dhe të konfirmuar nga Ministria e Financave. Ky fond do të përdoret sipas të dhënave në tabelën e mëposhtme:

Gr.	Kap.	Programi	Llog. Ekon	Kodi i programit	Kodi i institucionit	Emri i institucionit	Emërtimi i projektit	Kodi i projektit	Fondi në lekë
00	2	Planifikimi Urban Vendor	231	06140	2107001	Bashkia Durrës	Projekti SUMO 2.0	G107010	4,010,444

2. Kjo shumë të përdoret për mbulimin e shpenzimeve për zhvillim të aktiviteteve të projektit që lidhen me tre paketa pune kryesore që synojnë përmirësimin e lëvizshmërisë së qëndrueshme dhe lidhjeve port-qytet në Adriatikun Jugor, si: ekspertiza të jashtme dhe shërbime për takime lokale, udhëtime jashtë vendit, kancelari dhe përkthim/noterizim, përgjatë gjithë kohëzgjatjes së projektit (01.07.2025 – 31.12.2027).
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Turizmit, Drejtoria e Buxhetit dhe Drejtoria Ekonomike.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

**KRYETAR**


**Denisa Luarasi**



**U shpall sot me datë 15.06.2026**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT Durrës



Nr. 417/12 prot.

Durrës, më 22 . 06 .2026

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK  
DURRES

KRYETARIT TË BASHKISË  
DURRES

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.23 datë 12.06.2026 ,” Për miratimin e përdorimit të fondit prej 4010444 (katër milionë e dhjetë mijë e katërqind e dyzet e katër) lekë të parafinancuara nga projekti Sustainable Mobility Upgrade - Sumo 2.0, programi Interreg Ipa South Adriatic (2021-2027 ”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” i ndryshuar, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI  
ADRIAN GURRA

